

FATMIR AGALLIU

DISKUTIM RRETH PROBLEMIT TË KLASIFIKIMIT TË FOLJEVE NË ZGJEDHIME

Ndarja e foljeve në zgjedhime, sipas mendimit tim, duhet të përfshijë gjithë foljet, duke futur këtu edhe ato që zakonisht nëpër gramatikë shkollore quhen të parregullta. Parregullësia e tyre përmbledhet në ndryshimet e temës, ndryshime që mund të jenë ose të një karakteri fonetik tepër largvajtës, ose që kanë të bëjnë me fenomenin e supletivizmit. Por zgjedhimi në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhë të tjera indoevropiane, ka të bëjë kryesisht me sistemin e mbaresave dhe jo me ndryshimet e temës, të cilat mund të jenë të rregullta si në foljet marr — mor-a, heq — hoq-a, sjell — soll-a dhe të parregullta si në foljet ha — hëngr-a, dua — desh-a. Grupimi në zgjedhime edhe i të ashtuquajturave folje të parregullta është i leverdisshëm në pikëpamje praktike.

Përrjashtim duhet bërë vetëm për foljet *jam*, *kam* dhe *them*, për të cilat duhet thënë se i takojnë një zgjedhimi të veçantë, të vjetër, por jo produktiv.

Para klasifikimit të foljeve në zgjedhime duhet folur për temat themelore të foljes në gjuhën shqipe. Tek folja dallohen tri tema: tema e kohës së tashme, tema e së kryerës së thjeshtë dhe ajo e pjesores. Për një pjesë të foljeve këto tema përputhen: hap — hap-a — hapu-r, mbyll — mbyll-a — mbyll-ur; tek folje të tjera ato ndryshojnë ose të tria: jap — dha-shë — dhë-në, ose e tashmja dhe pjesorja dalin njëllor dhe e kryera e thjeshtë ndryshon: marr — mor-a — marr-ë, mbjell — mboll-a — mbjell-ë.

Ndarja e foljeve në folje me temë të pandryshueshme e në folje me temë të ndryshueshme ka rëndësi për dallimin e klasave të ndryshme brenda zgjedhimeve.

Foljet me temë të ndryshueshme nga ana e tyre mund t'i ndajmë në tri grupe: 1) me zgjerim teme në të tashmen: *vras* (vret) — *vra-va*, *ngas* (nget) — *nga-va*, me zgjerim teme në të kryerës e thjeshtë: *bë-j* — *bër-a*, *hy-j* — *hyr-a*, *gje-j* — *gjet-a* (në pjesore *gjet-ur*), *mba-j* — *mbajt-a* (në pjesore *mbajt-ur*); 2) me fenomene fonetike, më shpesh me alternime zanore: *marr* — *mor-a* (këto folje rregullisht kanë alternime zanore edhe në vetat II-III njëjës dhe në veten II shumës: *merr* — *mirr-ni*); me alternime zanore dhe bashkëtingëlloresh bashkë: *djeg* — *dogj-a*, *pjek* — *poq-a*, *vdes* — *vdig-a*, *vras* — *vret*; me alternime bashkëtingëlloresh: *rris* — *rrit*, *godis* — *godit*; 3) me temë supletive: *jap* — *dha-shë* — *dhë-në*, *bie* — *ra-shë* — *rë-në*.

Lidhur me çështjen se cila formë e foljes duhet vënë në bazë të klasifikimit në zgjedhime edhe unë mendoj se kjo formë duhet të jetë ajo e kohës së tashme të mënyrës dëftore. Është e vërtetë se e tashmja e dëf-

tores nuk mund të quhet një formë përfaqësuese e tillë siç është rasia emërore tek emri, por ajo ruan më mirë se të gjitha format e tjera temën e parë të foljes dhe në këtë formë foljet diferencohen më qartë. Nga kjo pikëpamje ne nuk mund të mbështetemi dot në temën e pjesore, sepse në pjesore folje të zgjedhimeve të ndryshme shpeshherë dalin njëlloj. Kështu foljet *pi* dhe *laj*, që për ne u takojnë dy zgjedhimeve të ndryshme, në pjesore nuk diferencohen dot: *pirë, larë*. Po ashtu foljet *gjej* dhe *blej* që janë të një zgjedhimi, në pjesore ndryshojnë: *gjetur, blerë*.

Mbështetja në format gramatikore të kohës së tashme për ndarjen e zgjedhimeve nuk është një gjë e panjohur edhe për gramatikat e gjuhëve të tjera. Kështu bëjnë, përshembull, dy nga gramatikat e rusishtes për shkollat e larta, ajo e universitetit të Moskës (Sovremennyj russkij jazyk, II, 1964, fq. 161) dhe gramatika e Gvozdevit (Sovremennyj russkij jazyk, I, 1967, fq. 348).

Por për përcaktimin e zgjedhimeve nuk duhet të mbështetemi vetëm në tingullin fundor të temës së kohës së tashme të mënyrës dëftore, sepse kjo nuk është e mjaftueshme. Duhet pasur parasysh edhe mbaresat e tri vetave të njëjësit, madje këto në radhë të parë. Neve na duket më e drejtë që kështu të veprojmë edhe fjalori i ardhshëm i gjuhës shqipe; pra edhe në fjalor foljet të jepen në veten e parë e të dytë. Veta e tretë, në ato raste kur folja pëson ndryshime, meqenëse është e njejtë me vetën e dytë, s'ka nevojë të jepet. Në Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954 dhe në «Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës sotme shqipe» (Studime filologjike, 2, 1968, fq. 118) jepet vetëm trajta e vetës së parë të së tashmes së mënyrës dëftore.

Fakti që foljet *la-j*, *shkri-j* nga një anë dhe foljet *pi*, *di* nga ana tjetër kanë zanore në fund të temës së kohës së tashme, por ndryshojnë mjaft në zgjedhim, e bën të domosdoshme mbështetjen në mbaresat për të dalluar zgjedhimet. Foljet e grupit të parë kanë mbaresa për të tri vetat e njëjësit: *-j*, *-n*, *-n*, kurse të dytat dalin pa mbaresa. Në tri vetat e shumësit të parat marrin mbaresat *-jmë*, *-ni*, *-jnë*, kurse të dytat *-më*, *-ni*, *në*.

Pavarësisht nga numri relativisht i pakët i foljeve që përfshin (këtu ne fusim edhe të parregulltat), zgjedhimi i foljeve të tipit *pi*, *di*, *fle*, *ha*, *vë*, *lë* etj. duhet të përbëjë një ndarje më vete dhe, sipas rendit, duhet të vijë i fundit, sepse është jo produktiv. Renditja e zgjedhimeve sipas prodhimitarisë (produktivitetit) është e drejtë. Duke u pajtuar me autorin e artikullit për zgjedhimet që po botohen në këtë numër, mendoj që foljet tema e të cilave mbaron me zanore ose dyzanor dhe në tri vetat e njëjësit të kohës së tashme merren mbaresat *-j*, *-n*, *-n*, të grupohen në zgjedhimin e parë.

Meqë foljet e tipit rris-rrit, godis-godit, shes-shet, megjithë alternimin e një tipi të veçantë në bashkëtingëllore, që është veshur me një funksion morfologjik kuptim-dallues, nuk ndryshojnë nga foljet e tjera në bashkëtingëllore, mund dhe duhet të përfshihen së bashku me gjithë foljet që u mbaron tema me bashkëtingëllore, në një zgjedhim më vete, i cili, sipas rendit, duhet të vijë i dyti.

Kështu, foljet e gjuhës shqipe mund të klasifikohen në tre zgjedhime. Zgjedhimi i parë të përfshijë foljet e tipit *laj*, *blej*, *punoj*, *shkruaj* etj., zgjedhimi i dytë foljet e tipit *hap*, *sjell*, *djeg*, *rris*, *shes* etj. dhe zgjedhimi i tretë foljet *pi*, *di*, *fle*, *ha*, *lë*, *zë* etj. Kjo ndarje të bëhet në bazë të kriterëve që u parashtruan më sipër. Ndarja në klasa brenda secilit zgjedhim duhet bërë sipas formave të ndryshme të ndryshimit të temës, për të cilat u fol më sipër. Ndërkaq mund të shihet mundësia që foljet

me zgjerim teme së bëj — bër-a, hy-j — hyr-a, vë — vur-a, zë — zur-a, mbaj — mbajt-a, gje-j — gjet-a, vras — vrava, shkas — shka-va, pres — pre-va, ngas — nga-va etj. të përfshihen në një zgjedhim të përzjerë. Këto folje një pjesë të trajtave të paradigmës së zgjedhimit i formojnë sipas modelit të zgjedhimit të parë ose të tretë dhe një pjesë tjetër sipas modelit të zgjedhimit të dytë, d.m.th. një pjesë e foljeve të këti grupi në të tashmen dalin me temë konsonantike, kurse në aorist me temë vokale dhe pjesa tjetër në të tashmen del me temë vokale, ndërsa në aorist me temë konsonantike. Kundërvënja e së tashmes me aoristin është me rëndësi për zgjedhimin e foljeve të gjuhës shqipe. Sipas kësaj kundërvënjeje dallohen dy zgjedhime, zgjedhimi vokalik dhe ai konsonantik. Format e së pakryerës nuk kanë rëndësi, sepse në këtë kohë foljet zgjedhohen njëllor; bën përjashtim vetëm veta e tretë njëjës që në foljet me zanore merr një *-n* para mbaresës *-te*. Mirëpo mbështetja në kundërvënjen aorist-prezent nuk është e mjaftueshme, sepse midis foljeve vokale në të tashmen ka ndryshime të qenësishme në zgjedhim, që na detyrojnë të pranojmë ndarjen në tri zgjedhime, duke u bazuar kryesisht në mbaresat e së tashmes. Format e aoristit, siç thuhet më tej drejtë në artikullin e Sh. Demirajt, do t'i kemi parasysh për përcaktimin e klasave të secilit zgjedhim.

Për disa çështje të veçanta që shtrihen në artikull, kam këto vërejtje: a) Për klasifikimin e foljeve në zgjedhime dhe për klasifikimin e tyre të mëtejshëm në nënzgjedhime e klasa nuk është e domosdoshme të zbatohet një kriter i vetëm. Për grupimin e foljeve në zgjedhime rëndësi të dorës së parë marrin mbaresat, kurse për dallimin e klasave dhe të nënklasave ndryshimet e temave. Këtu mendoj se nuk ka ndonjë kontradiktë.

b) Arësytet që jepen për të argumentuar pamundësinë e mbështetjes në trajtat e pjesores për klasifikimin e foljeve në zgjedhime janë të drejta, mirëpo nuk ngrenë peshë për problemin në fjalë. Kështu fakti se trajtat *larë*, *hapur* «në shqipen e sotme nuk kanë vlerën e paskajores, por atë të pjesores së shkuar pësore», se pjesorja ka një larmi formash dhe mundësi shumë të kufizuara për t'u përdorur si gjymtyrë më vete e fjalisë as nuk e përforcon as nuk e rrëzon dot mendimin se duhet marrë për bazë trajta e pjesores. Arësytet që e bëjnë të pamundur mbështetjen në trajtat e pjesores besoj t'i kem sqaruar më sipër.

c) Foljet vë — vur-a, — vënë, zë — zur-a — zënë, nxë — nxura — nxënë që futen në të rregulltat dhe klasifikohen në zgjedhime, nuk janë më pak të parregullta nga disa folje të tjera si lë — la-shë — lënë, shpie — shpur-a — shpë-në.

d) Projekti i paraqitur nga shoku Shaban ka shumë ndarje në nënklasa, të cilat e vështirësojnë lëndën; sidomos për një tekst mësimor grupimet duhet të jenë më të përgjithshme.

